



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 116 prot.

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 99 Datë 27/072022

MBI

“MIRATIMIN E MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN DHE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULEVARDI I RI, SHKOZË” PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.87 Datë 26.07.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot, datë 21.07.2022 dhe Bashkisë Kamëz me nr.6609 prot, datë 21.07.2022 “Për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga zbatimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.571 prot, datë 15.07.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Manuali për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë” për Njësinë Administrative Paskuqan” paraqitet në ankesin bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

